

Ne bazë të nenit 14 dhe nenit 58 pika a), b), d), g) i), të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40 dhe në përputhje me nenin 6, 7, 8 dhe 9 të Ligjit nr.04/L-144 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së palujtëshme të Komunës, dhe nenet 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17 dhe 18 të Kapitullit III të Rregullores së QRK-së Nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Palujtëshme të Komunës si dhe nenit 21 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.29.01.2016, bie këtë::

V E N D I M

PËR SHPALLJEN FITUESE TË OFERTËS SË PËRZGJEDHUR PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË (99) VITE TË TOKËS NDËRTIMORE KOMUNALE ME KONKURS PUBLIK-LLOTI NR.2

I.

Merret Vendimi për SHPALLJEN FITUESE të ofertës së përzgjedhur për dhënie në shfrytëzim afatgjatë (99) vite të tokës ndërtimore në pronësinë komunale me konkurs publik, me qëllim të ndërtimit të lartë në qytetin e Deçanit, i cili përfshinë ngastrat në vijim: Ngastra nr.0941 në sipërfaqe 1083 m², me kulturë guri dhe ngastra nr.0944 në sipërfaqe 62 m² me kulturë shtëpi ndërtuesë.

II.

Në shënimet vijuese është paraqitur oferta e ofertuesit të përzgjedhur nga komisioni dhe të miratuar nga Kuvendi i Komunës e cila shpallet fituese e Llotit nr.2.

LLOTI 2

Ndërtimi dhe Rregullimi Urban i Bllokut afarist dhe banesorë B+P+3 në ngastrën kadastrale nr.0941, e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-70505021-00941-0, me sipërfaqe 1083 m² dhe nr.0944 e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-70505021-00944-0, në sipërfaqe prej 62 m² Komuna Kadastrale Deçan, P:1/1000 (plai i situacionit), Zona e I(parë) në Deçan, – Hapësira te parkingu i postes.

Shpallet fituese:

Oferta e përzgjedhur nga Komisioni dhe e miratuar nga Kuvendi.

“Hysen Gashi-ENEX TRADE”-Pejë, Visar Kelmendi

E ofruar për komunën 22 %

Afarizem bruto sipërfaqja..... 868.72 m² x 22% = 191.12 m² x 720.00 € = 137,606.40 €.

Banim bruto sipërfaqja.....1,043.66 m² x 22% = 229.60 m² x 360.00 € = 82,656.00 €

Garazha-parkingu bruto sipërfaqja..434.36 x22% =95.56 m² x 180.00 € = 17,200.80 €

Totali i 22% i ofruar per Komunen i llogaritur ne mjete financiare.....237,463.20 €

III.

Për Llotin nr.2. hapësira e ofruar në përqindje për Komunën nga ofertuesi 22% e metrave katrorë do të zbërthehet në mjete financiare sipas Rregullores për Caktimin e Lartësisë së Taksave dhe Ngarkesave për Shërbimet Komunale dhe ato mjete do të derdhen në buxhetin komunal duke u bazuar në kontratën me ofertuesin e përzgjedhur.

IV.

Në dokumentet aneks të këtij Vendimi që do të ruhen në dosje janë: Listat e dorëzimit të ofertave nga ofertuesit, raportet e hapjes së ofertave nga komisioni si dhe raporti i vlersimit me procesin e përzgjedhjes së ofertës më të mirë.

IV.

Për zbatimin e vendimit të Kuvendit të Komunës sipas Ligjit Nr.04/L-144 obligohet Kryetari i Komunës që të lidhë kontratë me të cilën përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.

V.

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit në Asamble.

VI.

Me nga një kopje të vendimit do të paisen: MAPL për shqyrtim të ligjshmërisë, Kompania përzgjedhëse, Kryetari i Komunës dhe Arhivi.


01.Nr.I-4

Deçan, dt. 29.01.2016

Kuvendi i Komunës së Deçanit:

Kryesuesi i Kuvendit:

Jashar Dobraj



HYRËSE-JLAZMA-INTRODUK	
REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA E DEÇANIT • OPSTINA DEÇANE • DEÇAN MUNICIPALITY	
Ngaz:	Mr. Prot:
Od:	Bz. Prot:
From: K. Deçan AS	Prot. No. 3297
Nr. i faqeve:	Date:
Bz. Stranica: 01	Dated: 29.01.16
No Pages:	